VENDIM
Nr. 153, datë 12.11.2012

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 13, SERIA PV03K, TË SHOQËRISË "BALKAN GREEN ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "BARMASH", TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 20, DATË 19.12.2003, MODIFIKUAR ME VENDIMIN NR. 79, DATË 23.10.2009

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9, 13 pika 1 germa "a" dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa "b", pika 3 dhe pika 4 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikave 2.3 dhe 2.4 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Balkan Green Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Balkan Green Energy" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Është dhënë informacioni me shkrim, ku shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (neni 15 pika 4 germa "a");
- Është paraqitur vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës (neni 15 pika 4 germa "b").

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë modifikimin e licencës me nr. 13, seria PV03K, të shoqërisë "Balkan Green Energy" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Barmash", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003, modifikuar me vendimin nr. 79, datë 23.10.2009.
2. Fuqia e instaluar e hec "Barmash", nga 630 KW të bëhet 830 KW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani